

URDHËR
Nr. 167, datë 27.4.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE MË TË HOLLËSISHME PËR
PARAQITJEN DHE TRAJTIMIN E SHPREHJEVE TË INTERESIT, SI DHE
VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT TË KRITEREVE LIGJORE PËR PËRKTHYES
ZYRTAR DHE PËR INTERPRET TË GJUHËS SË SHENJAVE**

(Ndryshuar me urdhrin nr. 371, datë 19.7.2022; nr. 116, datë 27.2.2026)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të neneve 14, pika 6, dhe 15, pika 4, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”,

URDHËROJ:

Neni 1
Qëllimi

Ky urdhër ka për qëllim përcaktimin e rregullave më të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit nga kandidatët për përkthyes zyrtar dhe interpret të gjuhës së shenjave, si dhe verifikimin e plotësisimit të kriterëve ligjore.

Neni 2

Publikimi i thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit

1. Pas miratimit të ministrit të Drejtësisë të hapjes së thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave, thirrja publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë, 90 (nëntëdhjetë) ditë përpara datës së provimit të kualifikimit, të përcaktuar në urdhrin e ministrit të Drejtësisë.

2. Kur provimi i kualifikimit zhvillohet përpara afatit 2-vjeçar, sipas pikës 2, të nenit 16, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” (më tej ligji), thirrja për paraqitjen e shprehjeve të interesit publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë, 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara datës së provimit të kualifikimit, të përcaktuar në urdhrin e ministrit të Drejtësisë.

Neni 3

Paraqitja e shprehjes së interesit dhe dokumentacionit shoqërues

(Shtuar togfjalësh në shkronjën “e” dhe “c”, shtuar shkronjat “ë”, “f”, “ç” dhe “d” në pikat 3 dhe 5 me urdhrin nr. 116, datë 27.2.2026)

1. Kandidati për përkthyes zyrtar ose për interpret të gjuhës së shenjave paraqet pranë Ministrisë së Drejtësisë shprehjen e interesit dhe dokumentacionin shoqërues, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e publikimit të thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit.

2. Shprehja e interesit përmban këto të dhëna:

a) emrin, mbiemrin, atësinë, amësinë, datëlindjen, vendlindjen, numrin personal të identifikimit, gjininë dhe shtetësinë e kandidatit;

b) adresën e vendbanimit, numrin telefonik të kontaktit dhe adresën elektronike të kandidatit;

c) gjuhën/gjuhët për të cilat kandidati për përkthyes zyrtar do t'i nënshtrohet provimit të kualifikimit, në përputhje me listën e gjuhëve të huaja, të cilat përfshihen në shërbimin e përkthimit zyrtar të miratuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

3. Kandidati për përkthyes zyrtar paraqet pranë Ministrisë së Drejtësisë dokumentacionin shoqërues si vijon:

a) kopje të mjetit të identifikimit;

b) jetëshkrimin;

c) kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës së ciklit të dytë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara dhe të akredituara sipas dispozitave në fuqi në kohën e lëshimit të diplomës, ose diplomën e të njëjtit cikël, të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, të njohur e të njehsuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;

ç) vërtetim, nga institucionet ku ka ushtruar detyrën ose funksionin publik, se ndaj tij nuk është dhënë masa disiplinore e shkarkimit për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, ose nëse është dhënë kjo masë, vërtetim nga institucioni që kjo masë disiplinore është shuar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe lëshuar nga Universiteti i Tiranës, kur kandidati është shtetas i huaj;

dh) kopje të njehsuar me origjinalin të librezës së punës;

e) formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, të plotësuar dhe të nënshkruar dhe/ose vërtetimin e gjendjes gjyqësore;

ë) formularin e vetëdeklarimit mbi zotërimin e zotësisë së plotë për të vepruar, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse të tij, të plotësuar dhe të nënshkruar dhe/ose vërtetim nga gjykata për zotërimin e zotësisë për të vepruar;

f) në rast se përzgjedh kryerjen e njoftimeve të përcaktuara në këtë urdhër me mjete të komunikimit elektronik, deklarimin mbi dhënien e pëlqimit mbi kryerjen e njoftimeve me mjete të komunikimit elektronik, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse të tij, të plotësuar dhe të nënshkruar.

4. Kur kandidati është shtetas i huaj, përveç dokumenteve të përcaktuara në pikën 3, të këtij urdhri, paraqet edhe vërtetimin e gjendjes gjyqësore dhe vërtetimin mbi zotësinë e plotë për të vepruar, të lëshuara nga organet përgjegjëse të vendit të origjinës.

5. Kandidati për interpret të gjuhës së shenjave paraqet pranë Ministrisë së Drejtësisë dokumentacionin shoqërues, si vijon:

a) kopje të mjetit të identifikimit;

b) jetëshkrimin;

c) formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, të plotësuar dhe të nënshkruar dhe/ose vërtetimin e gjendjes gjyqësore;

ç) formularin e vetëdeklarimit mbi zotërimin e zotësisë së plotë për të vepruar, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse të tij, të plotësuar dhe të nënshkruar dhe/ose vërtetim nga gjykata për zotërimin e zotësisë për të vepruar;

d) në rast se përzgjedh kryerjen e njoftimeve të përcaktuara në këtë urdhër me mjete të komunikimit elektronik, deklarimin mbi dhënien e pëlqimit mbi kryerjen e njoftimeve me mjete të komunikimit elektronik, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse të tij, të plotësuar dhe të nënshkruar.

Neni 4

Kërkesa për përjashtimin nga dhënia e provimit të kualifikimit

Kandidati për përkthyes zyrtar, që plotëson kushtet për t'u përjashtuar nga detyrimi për dhënien e provimit të kualifikimit për përkthyes zyrtar, sipas parashikimeve të ligjit, përveç dokumentacionit të parashikuar në nenin 3, paraqet edhe dokumentacionin shoqërues, si vijon:

- a) kërkesën për përjashtimin nga provimi i kualifikimit;
- b) vërtetim nga institucioni i arsimit të lartë pranë të cilit ka punuar mbi periudhën e punësimit, si dhe lëndët që ka dhënë gjatë saj, si dhe kopje e njëhësuar me origjinalin të diplomës për marrjen e gradës ose titullit shkencor në fushën e përkthimit të gjuhës së huaj përkatëse, për kandidatin e parashikuar nga neni 16, pika 7, shkronja “a”, e ligjit;
- c) vërtetim nga institucioni pranë të cilit ka punuar mbi periudhën e punësimit, përshkrimin e punës, si dhe dokumente të tjera që provojnë punësimin e kandidatit pa ndërprerje si përkthyes në institucionet qendrore të administratës shtetërore, si dhe në organizatat ndërkombëtare ose në institucionet e Bashkimit Evropian, për kandidatin e parashikuar nga neni 16, pika 7, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit.

Neni 5

Verifikimi paraprak

(Zëvendësuar togfjalësh në pikën 1 me vendimin nr. 371, datë 19.7.2022; ndryshuar me urdhrin nr. 116, datë 27.2.2026)

1. Struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë vlerëson shprehjet e interesit dhe dokumentacionin shoqërues të kandidatit për përkthyes zyrtar ose për interpret të gjuhës së shenjave, brenda 20 (njëzetë) ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e tyre.
2. Kur shprehja e interesit dhe dokumentacioni shoqërues nuk përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij urdhri, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë njofton kandidatin për plotësimin e të metave, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit.
3. Në çdo rast, struktura përgjegjëse i njofton kandidatit numrin unik të identifikimit që do të përdoret për qëllime të publikimit të listave të kandidatëve të kualifikuar dhe të skualifikuar.

Neni 6

Verifikimi i kritereve

(Ndryshuar pika 1 dhe 5, shfuqizuar pika 2 me urdhrin nr. 116, datë 27.2.2026)

1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pas përfundimit të afatit për plotësimin e të metave, struktura përgjegjëse verifikon nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligj dhe në këtë urdhër, në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
2. Shfuqizuar.

3. Për verifikimin e kriterit të mosqenies i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 14, si dhe shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 15, të ligjit, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë kryen vetë kontrollin në sistemin elektronik përkatës ose, kur është e nevojshme, i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve informacionin mbi dënimin ose jo të kandidatit. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dërgon informacionin brenda 3 ditëve nga marrja e kërkesës.

4. Për verifikimin e kriterit të zotësisë për të vepruar, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë i kërkon gjykatës së rrethit gjyqësor, ku kandidati ka vendbanimin aktual dhe gjykatave të tjera, nëse kandidati ka pasur vendbanime të mëparshme, vërtetimin për zotërimin e zotësisë për të vepruar.

5. Në përfundim të verifikimit mbi plotësimin kriterëve ligjore, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë harton një relacion shpjegues për miratim nga Sekretari i Përgjithshëm. Në relacion pasqyrohen të dhënat e dokumentacionit të paraqitur dhe arsyet mbi propozimin për pranimin ose refuzimin e shprehjes së interesit, për secilin kandidat.

Neni 7

Publikimi i listës paraprake

Pas miratimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, lista paraprake me numrin unik të identifikimit të kandidatëve të kualifikuar për të marrë pjesë në provim dhe të kandidatëve të skualifikuar publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. Kandidatët e skualifikuar njoftohen me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit.

Neni 8

Ankimi ndaj skualifikimit të kandidatit

(Zëvendësuar togfjalësh në pikën 2 me urdhrin nr. 116, datë 27.2.2026)

1. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankohen pranë ministrit të Drejtësisë, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit mbi skualifikimin, duke bashkëlidhur argumentet dhe dokumentacionin që provon përmbushjen e kriterëve për dhënien e provimit të kualifikimit.

2. Grupi i punës, i ngritur me urdhër të Ministrisë së Drejtësisë, shqyrton ankimin dhe i propozon ministrit të Drejtësisë përfshirjen në listën e kandidatëve të kualifikuar, në rastet kur provohet përmbushja e kriterëve për dhënien e provimit ose skualifikimin përfundimtar të tij nga pjesëmarrja në provim. Ministri i Drejtësisë nxjerr urdhrin përkatës jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e paraqitjes së ankimit.

3. Struktura përgjegjëse përgatit edhe urdhrin e ministrit për skualifikimin e çdo kandidati, të renditur në listën paraprake të kandidatëve të skualifikuar dhe që nuk kanë paraqitur një ankim.

4. Urdhri i ministrit për skualifikimin e çdo kandidati i njoftohet kandidatëve të skualifikuar, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

5. Ndaj urdhrin të ministrit për skualifikimin e kandidatit mund të paraqitet padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 9

Publikimi i listës përfundimtare

Pas miratimit nga ministri i Drejtësisë, lista përfundimtare me numrin unik të identifikimit të kandidatëve të kualifikuar për provim publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe i përcillet komisioneve të posaçme përkatëse për provimet e kualifikimit për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave.

Neni 10

Strukturat e ngarkuara për zbatim

1. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

2. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme për njoftimin e këtij urdhri.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

Shtojca nr. 1

VETËDEKLARIM

MBI ZOTËRIMIN E ZOTËSISË SË PLOTË PËR TË VEPRUAR
(Shtuar me urdhrin nr. 116, datë 27.2.2026)

Unë, i nënshkruari/a

Emri: _____

Atësia: _____

Mbiemri: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

Numri personal (NID): _____

Vendbanimi: _____

në cilësinë e kandidati/es për përkthyes/e zyrtar/e/interpret/e i/e gjuhës së shenjave, në mbështetje të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, të ndryshuar dhe të urdhrin nr. 167, datë 27.4.2022 të ministrit të Drejtësisë, “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave”, i ndryshuar,

VETËDEKLAROJ, me përgjegjësi të plotë ligjore, se:

1. Zotëroj zotësinë e plotë për të vepruar, në kuptim të legjislacionit civil në fuqi;

2. Jam plotësisht i/e vetëdijshëm/e se ky vetëdeklarim paraqitet si dokumentacion për qëllime zyrtare dhe shërben si kusht për verifikimin e përmbushjes së kriterit të zotërimit të zotësisë së plotë për të vepruar sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, të ndryshuar;

Me këtë vetëdeklarim, jap edhe pëlqimin tim të shprehur, të lirë dhe të informuar që Ministria e Drejtësisë të përpunojë të dhënat e mia personale dhe të kryejë verifikimet e nevojshme pranë institucioneve publike kompetente, me qëllim verifikimin e vërtetësisë së këtij vetëdeklarimi, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Vendi: _____

Data: _____

Nënshkrimi: _____

Ky vetëdeklarim është hartuar me vullnet të lirë, pa asnjë imponim, dhe nënshkruhet prej meje për t’u përdorur në kuadër të trajtimit të shprehjes së interesit, si dhe verifikimit të plotësisë të kriterëve ligjore për përkthyes zyrtar/interpret të gjuhës së shenjave.

Vendi: _____

Data: _____

Nënshkrimi: _____

Shtojca nr. 2

VETËDEKLARIM

MBI MARRJEN E NJOFTIMEVE ME MJETE ELEKTRONIKE

(Shtuar me urdhrin nr. 116, datë 27.2.2026)

Unë, i nënshkruari/a:

Emri: _____

Mbiemri: _____

Numri personal (NID): _____

në cilësinë e kandidati/es për përkthyes/e zyrtar/e/interpret/e i/e gjuhës së shenjave, në mbështetje të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, të ndryshuar dhe të urdhrin nr. 167, datë 27.4.2022, të ministrit të Drejtësisë, “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësisë të kriterëve ligjore për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave”, i ndryshuar,

VETËDEKLAROJ, me përgjegjësi të plotë ligjore, se:

1. Jap pëlqimin tim të shprehur, të lirë dhe të informuar që njoftimet, komunikimet dhe çdo komunikim që lidhet me procedurën e trajtimit të shprehjes së interesit, verifikimit të plotësisë të kriterëve ligjore për përkthyes zyrtar/interpret të gjuhës së shenjave, si dhe çdo procedurë tjetër të parashikuar nga urdhri i sipërcituar, si dhe urdhri me nr. 192, datë 4.5.2022, i ministrit të Drejtësisë, “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe funksionimin e komisioneve të posaçme, tarifët për pjesëmarrje, organizimin e zhvillimin e provimit të kualifikimit për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave, si dhe për procedurën e mënyrën e vlerësimit të provimeve”, i ndryshuar, të kryhen nga struktura përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik;

2. Për qëllimet e mësipërme, deklaroj se adresa ime elektronike e kontaktit është

_____;

3. Jam i/e vetëdijshëm/e dhe pranoj se njoftimet e kryera nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik në të dhënat e kontaktit të deklaruara më sipër konsiderohen të vlefshme dhe të rregullta, në kuptim të legjislacionit në fuqi;

4. Marr përsipër përgjegjësinë për saktësinë, përditësimin dhe funksionalitetin e adresës elektronike të deklaruar, si dhe për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjoftimi në kohë i strukturës përgjegjëse për çdo ndryshim të tyre;

Ky vetëdeklarim është hartuar me vullnet të lirë, pa asnjë imponim, dhe nënshkruhet prej meje për t'u përdorur në kuadër të trajtimit të shprehjes së interesit, si dhe verifikimit të plotësisht të kritereve ligjore për përkthyes zyrtar/interpret të gjuhës së shenjave.

Vendi: _____

Data: _____

Nënshkrimi: _____